



Këshilla për sigurinë gjatë rrugtimit për në Shkollë



Planifikoni rrugën

Planifikoni rrugën më të sigurt me fëmijën për në shkollë. Rishikoni emrat e rrugëve dhe orientimet për të mos u humbur.



Rregullat e rrugës

Së bashku me fëmijet mësoni shenja e trafikut – për shembull, luani lojëra për të njohur kuptimin e tyre.



Shikoni mirë

Mësojuni fëmijëve të sigurohen që automjetet janë ndalur para se të kalojnë rrugën. Kontakti me sy me shoferët është i rëndësishëm.



Dëgjoni

Largoni kufjet apo pajisjet që mbulojnë dëgjimin gjatë ecjes – zërat e trafikut janë sinjale paralajmëruese.



Bëhuni të dukshëm

Sigurohuni që fëmija të veshë rroba me ngjyra të ndritshme ose reflektuese, veçanërisht në ditë me shi apo errësirë.



Jepni shembull të mirë

Mos kaloni rrugën në vende të pasigurta dhe përdorni gjithmonë dritën e gjelber për kembesor në semafor apo vijat e bardha të shënuara në rrugë.



Makina të parkuara

Shmangni ecjen në mes të makinave të parkuara – drejtuesit mund të mos i shohin fëmijët që kalojnë.



PRIORITET SIGURIA E KËMBËSORËVE

- ◆  **Si ta përdorim vendkalimin për këmbësorë**
Mësoni fëmijët si të përdorin vendkalimin e shënuar në mënyrë të sigurt   dhe të shikojnë nga të dy anët  para se të kalojnë rrugën.
- ◆  **Vetëdijesimi i drejtuesve të mjeteve**
Drejtuesit e automjeteve  duhet të jenë më të vëmendshëm afër shkollave  dhe vendkalimeve të këmbësorëve  , veçanërisht gjatë orëve të ardhjes dhe largimit nga shkolla.
- ◆  **Jepni shembull të mirë**
Tregoni sjellje të sigurt në rrugë për fëmijët tuaj  – mos kaloni jashtë vijave të bardha  dhe gjithmonë ndalni për të parë trafikun .
- ◆  **Siguria në mjetin transportues shkollor**
Sigurohuni që fëmijët të kuptojnë rregullat e hyrje dhe daljes  nga autobusët shkollorë  si dhe sjelljet e sigurt përrreth tij.
- ◆  **Shmangni shpërqendrimet**
Shmangni përdorimin e telefonit   apo pajisjeve të tjera gjatë ecjes – sytë  dhe vëmendja duhet të jenë në rrugë .